

Vendim nr. 186 datë 19.09.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 19.09.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (C) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: CHRISTOS SIONTIS, përfaqësuar nga avokat Avni Shehu dhe avokat Bashkim Dedja, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-351, datë 14.02.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 15, 42, 121, 122, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, pikat 1 dhe 2, 71, pika 1, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*); ligji nr. 7760, datë 14.10.1993 “Për ratifikimin e Konventës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Greqisë për ndihmën gjyqësore në çështjet civile dhe penale” (*Konventa për ndihmë gjyqësore*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Christos Siontis (*kërkuesi*) është administrator i shoqërive “Siontis” s.a. dhe “Design and Construction Siontis” s.a., shoqëri të së drejtës greke me seli në Janinë, Greqi. Në vitin 1996 këto shoqëri të huaja kanë lidhur kontrata sipërmarrjeje në ndërtim me shoqërinë shqiptare “Gjallica Company” sh.p.k., duke arkëtuar prej saj një sasi të caktuar mjetesesh monetare. Në vitin 1997, pas daljes së ligjit për ndalimin e skemave piramidale mashtruese të huamarrjes, aktiviteti i kësaj të fundit është ndërprerë dhe ajo është vendosur në administrim duke iu nënshtruar kontrollit financiar sipas ligjit. Ndërkohë, në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 8215, datë 09.05.1997 “Për nxjerrjen e detyrimeve debitorëve dhe rikthimin e vlerave pasurore në llogaritë e personave juridikë, jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, administratorët e shoqërisë “Gjallica” sh.p.k. në administrim kanë marrë: (i) vendimin nr. 15, datë 11.08.1999, me të cilin shoqëria “Siontis” s.a. është deklaruar debitore për shumën 295 920 000 lekë; (ii) vendimin nr. 2, datë 07.09.2009, me të cilin shoqëria “Design and Construction Siontis” s.a. dhe kërkuesi si administrator i saj janë deklaruar debitorë për shumën 1 700 000 USD (dollarë amerikanë). Për këto vendime, tituj ekzekutivë, sipas ligjit të posaçëm, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka lëshuar urdhrat për ekzekutimin e tyre respektivisht me vendimet nr. 835, datë 18.04.2008 dhe nr. 312, datë 27.06.2008, si dhe me vendimin nr. 911, datë 25.03.2010. Në vijim, shoqëria “Gjallica” sh.p.k. në administrim ka ndërmarrë veprime për ekzekutimin e detyrimeve ndaj 2 shoqërive të huaja në fjalë dhe kërkuesit sipas vendimeve më lart, qoftë në Shqipëri, ashtu edhe në Greqi, ku ato kishin selinë e tyre, duke kërkuar përpara gjykatave greke njohjen dhe dhënien fuqi për zbatimin e vendimeve në atë shtet.

2. Në përfundim të procesit gjyqësor të zhvilluar në Republikën e Greqisë, Gjykata e Shkallës së Parë Janinë, me vendimin nr. 322/2012, datë 28.09.2012, ka pranuar kërkesën e shoqërisë “Gjallica” sh.p.k. në administrim, duke shpallur të ekzekutueshëm në Greqi vendimin nr. 911, datë 25.03.2010 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me të cilin është shpallur debitore shoqëria “Design and Construction Siontis” s.a. për shumën 1 700 000 USD, si dhe vendimet nr. 835, datë 18.04.2008 dhe nr. 312, datë 27.06.2008 të po kësaj gjykate, me të cilat shoqëria “Siontis” s.a. është shpallur debitore për shumën 295 920 000 lekë ose 3 000 000 USD. Ky vendim është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Janinë me vendimin nr. 102/2013, datë 29.04.2013, e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “Gjallica” sh.p.k., ndërsa Gjykata Supreme, me vendimin nr. 2264/2014, datë 19.12.2014, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit.

3. Në datën 14.01.2016, duke u mbështetur në nenet 393 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë me kërkesë për njohjen në Republikën e Shqipërisë të vendimeve të gjykatave greke sipas paragrafit 3 të këtij vendimi. Në përfundim të shqyrtimit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 39, datë 24.03.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligj. Për rekursin e kërkuetit kundër këtij vendimi, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-351, datë 14.02.2024, ka vendosur mospranimin e tij me arsyetimin se pretendimet e ngritura në të nuk janë nga ato të parashikuara në nenin 472 të *KPC*-së.

4. Në datën 14.06.2024, kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 27.06.2024.

II

Pretendimet e kërkuetit

5. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtim të:

5.1.1. *Së drejtës së aksesit në gjykatë*, pasi kërkuetit i është mohuar e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, për t'u dëgjuar dhe për të marrë përgjigje përfundimtare për kërkimin e tij. Qëndrimet e gjykatave se kërkuesi nuk ka interes të ligjshëm për paraqitjen e kërkesës, se vendimi i gjykatës së huaj është vendim refuzimi njohjeje të vendimit të gjykatës shqiptare në Greqi dhe se ky vendim nuk përmban detyrime me pasoja ekzekutimi në Shqipëri, janë haptazi në dëm të interesave të kërkuetit dhe në kundërshtim me nenin 393, pika 2, të *KPC*-së dhe Konventës për ndihmë gjyqësore. Kërkuesi ka interes të ligjshëm për dhënien fuqi në Shqipëri të vendimit të gjykatës greke, jo vetëm për faktin se nga ky vendim rrjedhin detyrime monetare, por edhe për ta pasur atë si provë në procesin civil për të provuar faktin se vendimet e administratorëve të shoqërisë “Gjallica Company” sh.p.k. janë marrë në mungesë dhe pa dijeninë e kërkuetit, pra në një proces të parregullt, si dhe për ta përdorur atë si provë në kërkimin për rishikimin e atyre vendimeve të gjykatave shqiptare të marra në mungesë të kërkuetit.

5.1.2. *Parimeve të gjykatës së caktuar me ligj dhe sigurisë juridike në lidhje me pritshmëritë e ligjshme*, pasi gjykatat duhet të veprojnë brenda kompetencave që u janë dhënë nga ligji, ndërkohë që në rastin konkret i janë shmangur detyrimit për respektimin e hierarkisë së akteve, të parashikuar në nenin 122 të Kushtetutës, ndërsa nuk kanë zbatuar dispozitat e Konventës për ndihmë gjyqësore, duke

cenuar parimin e sigurisë juridike në lidhje me pritshmëritë e ligjshme të kërkuesit për pranimin e kërkesës.

5.1.3. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar me hollësi se përse nuk i merr parasysh pretendimet e ngritura nga kërkuesi në rekurs dhe në parashtrimet shtesë, duke u mjaftuar vetëm me frazën se gjykata e apelit ka analizuar ligjin e provat duke u dhënë përgjigje pretendimeve të palës dhe se vendimi i saj nuk është në kundërshtim me kërkesat formale.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

6. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

7. Kolegji çmos se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

8. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në gjykatën e apelit dhe në Gjykatë të Lartë dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

9. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 14.02.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 14.06.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

10. Për sa i takon legjitimitit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, parimit të gjykatës së caktuar me ligj dhe atij të sigurisë juridike në lidhje me pritshmëritë e ligjshme, si dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Lartë.

11. Për sa i takon pretendimit për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj dhe atij të sigurisë juridike në lidhje me pritshmëritë e ligjshme, kërkuesi ka parashtruar se gjykatat duhet të veprojnë brenda kompetencave që u janë dhënë nga ligji, ndërkohë që në rastin konkret i janë shmangur detyrimit për respektimin e hierarkisë së akteve, të parashikuar në nenin 122 të Kushtetutës, ndërsa nuk kanë zbatuar dispozitat e Konventës për ndihmë gjyqësore sikurse përcakton neni 393, pika 2, i KPC-së, duke cenuar parimin e sigurisë juridike në lidhje me pritshmëritë e ligjshme të kërkuesit për pranimin e kërkesës. Referuar argumenteve të kërkuesit, Kolegji vlerëson se ato, në thelb, kanë të bëjnë me identifikimin e kuadrit ligjor të zbatueshëm në çështjen e tij, ndaj pretendimet e tij do të trajtohen në kuadër të pretendimit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor.

12. Nga ana tjetër, Kolegji vëren se në përmbajtjen e ankimit kushtetues pretendimet e kërkuesit adresohen edhe ndaj vendimit të gjykatës së apelit, ndërkohë që në objektin e tij kundërshtohet vetëm vendimi i Gjykatës së Lartë. Pavarësisht kësaj, duke qenë se thelbi i ankimit lidhet me procesin gjyqësor në tërësi, pretendimi për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor do të trajtohet në këtë kontekst, ndaj, duke vlerësuar se ky pretendim *prima facie* bën pjesë në juridiksionin e Gjykatës, do të analizohet në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor

13. Kërkuesi ka pretenduar se përfundimet e gjykatave për mungesën e interesit të tij të ligjshëm për paraqitjen e kërkesës, të qenies së vendimit të gjykatës së huaj një vendim refuzimi njohjeje të vendimit të gjykatës shqiptare në Greqi, i cili nuk përmban detyrime me pasoja ekzekutimi në Shqipëri, janë haptazi në dëm të interesave të tij dhe në kundërshtim me nenin 393, pika 2, të KPC-së dhe Konventës për ndihmë gjyqësore, ndërsa ato nuk e kanë zbatuar këtë të fundit në shkelje të parimit të hierarkisë së akteve, të parashikuar nga neni 122 i Kushtetutës. Sipas tij, ai ka interes të ligjshëm për dhënien fuqi në Shqipëri të vendimit të gjykatës greke, jo vetëm për faktin se nga ky vendim rrjedhin detyrime monetare, por edhe për ta pasur atë si provë në procesin civil për kundërshtimin e vendimeve të administratorëve të

shoqërisë “Gjallica” sh.p.k., përveçse edhe për ta përdorur atë si provë në kërkimin për rishikimin e vendimeve të gjykatave shqiptare të marra në mungesë të kërkuesit. Po ashtu, sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar me hollësi në vendimin e saj se përse nuk i merr parasysh pretendimet e ngritura në rekurs dhe në parashtrimet shtesë.

14. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas Gjykatës, detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse dhe se arsyetimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjit të Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 28, datë 01.11.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Për vendimet e dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit Gjykata ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i dhomës së këshillimit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për proces të rregullt ligjor. Shqyrtimi i çështjes nga dhoma e këshillimit e Gjykatës së Lartë nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018; nr. 27, datë 27.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Po ashtu, Gjykata ka theksuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me

konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin në shqyrtim, referuar akteve bashkëlidhur kërkesës, Kolegji konstaton se procesi i kundërshtuar është vënë në lëvizje nga kërkuesi, i cili, mbështetur në nenet 392 e vijues të KPC-së, i ka kërkuar Gjykatës së Apelit Tiranë të njohë në Republikën e Shqipërisë vendimet e gjykatave greke, me të cilat është vendosur rrëzimi i kërkesës së shoqërisë “Gjallica” sh.p.k. për njohjen dhe dhënien fuqi për zbatim në Republikën e Greqisë të disa vendimeve të gjykatave shqiptare, me të cilat janë shpallur debitorë kërkuesi dhe dy shoqëritë greke që e kanë atë administrator. Në përfundim të shqyrtimit, ajo gjykatë ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligj. Sipas gjykatës së apelit, ligji procedural civil shqiptar lejon njohjen dhe dhënien fuqi në Republikën e Shqipërisë të vendimeve të gjykatave të huaja në funksion të realizimit të të drejtave subjektive të njohura përmes atyre vendimeve, duke mundësuar zbatimin e tyre në Shqipëri, ndërkohë që në rastin konkret vendimi i gjykatës greke objekt kërkesë është një vendim refuzimi i njohjes së vendimeve të gjykatës shqiptare në Republikën e Greqisë. Po ashtu, sipas asaj gjykate, ndryshe nga sa kërkuesi pretendon, nuk mund të njihet një vendim i tillë i gjykatës së huaj mbi shkakun e përdorimit të tij si provë përpara gjykatave shqiptare që po shqyrtojnë mosmarrëveshje në lidhje me procesin e shpalljes debitor ose të ekzekutimit të titujve ekzekutivë, pasi janë ato gjykata që duhet të vlerësojnë pretendimet e kërkuesit për parregullsinë e procesit të shpalljes debitor.

18. Në vijim, Kolegji konstaton se rekursi i paraqitur nga kërkuesi kundër vendimit të gjykatës së apelit është shqyrtuar në dhomën e këshillimit nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se pretendimet e ngritura në të nuk janë nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Në vendimin e saj ajo gjykatë ka evidentuar të dhënat në lidhje me çështjen, kërkimet dhe pretendimet e kërkuesit, si dhe trajtimin e tyre e vendimmarrjen e gjykatës së apelit, përveçse ka evidentuar edhe shkaqet e parashtruara në rekursin e tij, sikundër edhe ato të ngritura në një parashtrësë me shkrim të depozituar përpara shqyrtimit të rekursit. Në vijim, ajo gjykatë ka evidentuar vlerësimin e arritur prej saj për mosplotësimin e kushteve të pranueshmërisë për shqyrtim të rekursit, pasi në të nuk ngrihen shkaqe nga ato të parashikuara nga ligji (neni 472 i KPC-së), pasi: Gjykata e Apelit Tiranë ka respektuar normat procedurale, të cilat mund të çojnë në pavlefshmërinë e vendimit gjyqësor ose të procedurës së gjykimit dhe nuk rezulton të ketë shkaqe të rënda procedurale, të cilat të kenë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimit; palës kërkuese i është dhënë mundësia të realizojë të drejtën e parashtrimit të kërkimeve të saj, të paraqesë prova, duke u respektuar të gjitha parimet bazë të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor; gjykata e apelit ka respektuar dhe zbatuar drejt dispozitat e KPC-së lidhur me njohjen e vendimeve të gjykatave të huaja,

duke bërë një cilësim të drejtë të fakteve dhe rrethanave që lidhen me kërkesën dhe e ka zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, duke u dhënë përgjigje ezauruese pretendimeve të ngritura nga pala kërkuese; vendimi i gjykatës së apelit nuk vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Civil ose Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

19. Për sa më sipër, bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, Kolegji vëren se kërkuesi ka ushtruar lirisht të drejtën e paraqitjes së kërkesës, sikurse edhe të drejtën e ankimit dhe përmes një procesi gjyqësor, që ka analizuar themelin e çështjes, me vendim përfundimtar ka marrë përgjigje të arsyetuar për kërkesën e tij. Vendimi i kundërshtuar i gjykatës së apelit tregon mjaftueshëm rrethanat e çështjes, faktet e pranuar dhe përfundimet e nxjerra nga ajo, si dhe dispozitat ligjore në të cilat ajo gjykatë është bazuar për zgjidhjen e çështjes në atë mënyrë. Gjykata e apelit ka vlerësuar provat dhe pretendimet e kërkuetit, por në analizë të tyre, si dhe ligjit të zbatueshëm, ajo gjykatë ka arritur në përfundime jo të njëjta me të.

20. Po ashtu, Kolegji vëren se edhe vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i marrë në dhomën e këshillimit, në funksion të shqyrtimit paraprak të rekursit, tregon rrethanat e çështjes, vendimmarrjen e gjykatës së apelit, shkaqet e ngritura në rekursin e kërkuetit, ligjin e zbatueshëm dhe pjesën arsyetuese ku mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Përmes parashtrimit të shkaqeve të rekursit në vendimin gjyqësor të kundërshtuar, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë tregon se pasi i ka vlerësuar ato ka arritur në përfundimin se rekursi i paraqitur nga kërkuesi është haptazi i pabazuar, pasi shkaqet e ngritura në të nuk gjenin mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore. Ky vendim nuk rezulton të jetë kontradiktor në përmbajtjen e tij.

21. Nga ana tjetër, për sa i përket pretendimit të kërkuetit, që në thelb ka të bëjë me interpretimin dhe zbatimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme, Kolegji vlerëson se ato nuk janë çështje që përfshihen në juridiksionin e Gjykatës, për sa kohë nga ajo nuk argumentohet se zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Kërkuesi pretendon se gjykatat e zakonshme nuk kanë identifikuar saktë ligjin e zbatueshëm në rastin konkret, i cili, sipas tij, është Konventa për ndihmë gjyqësore, referuar për këtë nenit 393, pika 2, të KPC-së. Kolegji vëren se kjo dispozitë ligjore bën fjalë për kushtet e zbatimit të vendimeve të gjykatave të huaja, të cilat parashikohen në këtë kod ose në ligje të veçanta dhe kur për këtë qëllim ka marrëveshje të posaçme ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shtetit të huaj, zbatohen dispozitat e marrëveshjes. Në kapitullin e tretë të marrëveshjes dypalëshe në fjalë, palët kanë rënë dakord edhe për njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore, duke përcaktuar llojin e vendimeve (civile, familjare, tregtare, penale, të arbitrazhit) (neni 23) dhe kushtet e njohjes dhe të zbatimit (neni 24), ndërsa këto të fundit janë të njëjta me ato që neni 394 i KPC-së i ka përcaktuar në mënyrë negative si pengesa ligjore për zbatimin e vendimeve

të gjykatave të huaja. Kërkuesi nuk tregon për ndonjë diferencë mes kushteve për zbatimin e vendimeve të gjykatave të huaja të parashikuara në atë marrëveshje dypalëshe me ato të parashikuara në KPC, që është identifikuar nga gjykata e apelit si ligji i zbatueshëm, dhe se si pasaktësia e pretenduar në këtë drejtim i ka cenuar atij të drejta kushtetuese. Për rrjedhojë, vetëm fakti se në përfundim të procesit gjyqësor, në të cilin kërkuesi ka pasur mundësinë të ushtrojë garancitë e tij procedurale, gjykatat kanë dhënë një vendim jo në favor të tij, nuk është i mjaftueshëm për të provuar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor.

22. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar. Për rrjedhojë, kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.